

Kryetari i Komunës së Tuzit, duke proceduar sipas propozimit të Komisionit për ndarjen e bursave numër 02-030/19-8540 prej më 09.12.2019, në bazë të nenit 10 të Vendimit mbi bursimin e studentëve në Komunën e Tuzit („Fleta Zyrtare e MZ – dispozitat komunale“ numër 32/19) ka sjellë:

V E N D I M

mbi ndarjen e bursave

U ndahen bursa kandidatëve të cilët me propozim të Komisionit kanë plotësuar kushtet nga Konkursi dhe kanë plotësuar kushtet nga Vendimi mbi bursimin e studentëve në Komunë të Tuzit, e të cilët kanë marrë pjesë në Konkursin për ndarjen e bursave të publikuar në tabelën e lajmërimeve të Komunës së Tuzit dhe në web faqen e Komunës së Tuzit.

Ndohen bursat për kandidatët në vijim:

1. Naza Mirsad Gjurgjeviq, Fakulteti i medicinës, viti i 6-shtë,
2. Linda Anton Lajçaj, Fakulteti i gjuhës angleze të biznesit, viti i 4-t,
3. Alberta Anton Bikaj, Fakulteti për ekonomi ndërkombëtare, financë dhe biznes, viti i 2-të
4. Hana Mediha Lulka, Fakulteti i shkencave politike, viti i 2-të,
5. Marija Tomë Lekogjeviq, Fakulteti i bioteknikës Podgoricë, viti i 3-të,
6. Dragan Vlada Pejoviq, Fakulteti i metalurgjisë teknike, viti i 3-të,
7. Xhenisa Xhema Nikoviq, Fakulteti filologjik Podgoricë, viti i 3-të.

A R S Y E T I M

Me nenin 10 të Vendimit mbi ndarjen e bursave në Komunë të Tuzit është paraparë që vendimin për ndarjen e bursave, në propozim të Komisionit, e sjellë kryetari i Komunës. Me nenin 2 të të njëjtit Vendim janë paraparë kushtet të cilat kandidatët duhet t'i plotësojnë në mënyrë që të merren në konsideratë në vendimmarje. Me aktin numër 02-030/19-5976 prej më 27.09.2019, Komisioni ka përcaktuar kriteret mbi të cilat ka bërë vlerësimin me pikë të kandidatëve. Në pajtim me rregullat e caktuara për vendimmarje Komisioni ka sjellë listën e vlerësimit me pikë, në bazë të të cilës sipas aktit 02-030/19-8540 prej më 09.12.2019 kryetari të Komunës, i është propozuar që bursat tu ndahen kandidatëve të cilët i plotësojnë kushtet e konkursit dhe të cilët janë renditur më së miri, gjegjësisht kanë më së shumti pikë.

Në bazë të asaj që u tha, është vendosur si në dispozitiv të Vendimit.

UDHËZIM MBI MBROJTJEN E JURIDIKE: Pkundër këtij Vendimi mund të parashtrohet ankese te Kryeadministratori i Komunës së Tuzit, përmes Arkivit të Komunës së Tuzit, në afat prej 15 ditësh nga dita e publikimit të të njëjtës në tabelën e shpalljeve dhe në web faqen e Komunës së Tuzit.

Nik Gjelošaj

KRYETARI,

